



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 02 Prot. Datë 14.05.2012

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 58/7 Prot. Datë 13.06.2012

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 124/9 Prot. Datë 10.9.2012

MINISTRIA E MBROJTJES

Nr. 06 Prot. Datë 25.6.2012

**MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE**
Nr. 5247 Prot. Datë 27.06.2012

UDHËZIM I PËRBASHKËT

“PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT PËR CAKTIMIN NË SEKSION TË PUNONJËSVE TË POLICISË GJYQËSORE”

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 10/a pika 2 të ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i ndryshuar, nenit 8 pika “gj” të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ligjit 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9069 datë 15.05.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J M Ë :

Neni 1 Objekti

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e procedurës së konkurrimit për:
 - a) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Policia e Shtetit, në varësi administrative të Ministrisë së Brendshme;
 - b) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Policia Ushtarake, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes;

- c) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga njësitë e hetimit tatimor, në varësi administrative të Ministrisë së Financave;
- ç) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (antikorrupsion), në varësi administrative të Ministrisë së Financave;
- d) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Policia Pyjore, në varësi administrative të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Neni 2

Caktimi në seksion

1. Caktimi i oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore të forcave policore, në seksionet e Policisë Gjyqësore, bëhet nga ministri që ka në kompetencë forcën policore që ligji i njej të drejtën e ushtrimit të funksioneve të Policisë Gjyqësore, dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Caktimi i oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore në seksionet e Policisë Gjyqësore bëhet sipas sipas parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr.8677 datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, (i ndryshuar), bazuar në një procedurë konkurrimi.

Neni 3

Rishikimi i organikës dhe vendet e lira

1. Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me ministrat që kanë në kompetencë forca policore që ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore, çdo dy vjet, rishikojnë organikat sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr.8677 datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, (i ndryshuar).
2. Kur lind nevoja e parashikimit të mbulimit të vendeve vakante, shpallja e vendeve vakante bëhet nga forca policore sipas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm.
3. Shpallja e vendeve vakante botohet në dy gazetatat me qarkullim më të madh të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar për konkurrim. Shpallja e vendeve vakante afishohet në një vend të dukshëm pranë strukturës më të lartë organizative në nivel vendor ku ndodhet pozicioni i lirë, si dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit përkatës.

Neni 4

Paraqitja e dokumentacionit

1. Dokumentacioni që dorëzohet nga kandidatët për oficerë ose agjentë të Policisë Gjyqësore pranë seksioneve përmban:
 - a) Kërkesën për t’u caktuar në seksionin e Policisë Gjyqësore duke treguar vendin që preferojnë;
 - b) Curriculum Vitae të detajuar;
 - c) Diplomën dhe listën e notave, të arsimit të lartë, të noterizuar, për kandidatët për oficer të Policisë Gjyqësore, dhe çdo dokument që plotëson kriterin e arsimit, sipas ligjit për forcën policore ku bën pjesë, për kandidatët për agjent të policisë gjyqësore;
 - ç) Librezën e punës;
 - d) Vlerësime të mëparshme të punës;
 - dh) Dëshmi të një gjuhe të huaj, të noterizuar (nëse ka);

- e) Diploma të tjera të arsimit pasuniversitar, si “Master i shkencave” etj (nëse ka);
 - f) Vërtetim nga gjykata që tregon se ndaj tij nuk ka çështje gjyqësore në proces.
 - g) Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
 - gj) Vërtetim nga Prokuroria se ndaj tij nuk ka filluar procedim penal.
2. Të interesuarit paraqesin dokumentacionin pranë strukutrave përkatëse të forcave policore brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendeve vakante.

Neni 5

Procedura e konkurrimit

1. Strukturat e forcave policore bëjnë përzgjedhjen paraprake të kandidatëve për oficerë ose agjentë të Policisë Gjyqësore, të cilët në bazë të fotokopjeve të dokumenteve të paraqitura, përmbushin kërkesat e nenit 10 të ligjit nr.8677 datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, (i ndryshuar).
2. Kandidatët e përzgjedhur sipas pikës 1 të këtij neni, i nështrohen testimit profesional i cili llogaritet maksimalisht 100 pikë dhe kalon në tre faza:

a) Faza e parë

“Vlerësimi i dokumenteve dhe pikëzimi”

- 2.1 Vlerësimi i diplomës, përvoja në punë, diplomat pasuniversitare, vlerësimi i mëparshëm i punës, njohuritë kompjuterike, gjuhët e huaja dhe kualifikime të tjera të kandidatëve, përbëjnë në total 25 pikë nga 100 pikët maksimale, si më poshtë:

- a) Diploma vlerësohet në maksimum me 5 pikë;
- b) Përvoja në punë në shërbimin e Policisë Gjyqësore mbi 10 vjet vlerësohet në maksimum me 5 pikë;
- c) Diplomë pasuniversitare, vlerësohet në maksimum me 5 pikë;
- ç) Vlerësimi i mëparshëm i punës, vlerësohet në maksimum me 5 pikë;
- d) Njohuri kompjuterike, gjuhë të huaja dhe kualifikime të tjera, vlerësohen në maksimum me 5 pikë.

b) Faza e dytë

“Intervista”

- 2.2. Testimi me anë të intervistës për njohuri të përgjithshme dhe specifike të fushës juridike, kryesisht penale, vlerësohet maksimalisht 25 pikë.

b) Faza e tretë

“Testimi me shkrim”

- 2.3. Testimi me shkrim përmban një test teorik dhe një test praktik, që vlerësohet në maksimum me 50 pikë.

Programi për testimin me shkrim përgatitet në bashkëpunim midis Ministrinë që ka në kompetencë forcën policore dhe Prokurorisë së Përgjithshme përpara shpalljes së vendeve vakante dhe u vihet në dispozicion kandidatëve me paraqitjen e dokumenteve, sipas nenit 4 të këtij udhëzimi.

Neni 6
Komisioni i vlerësimit të aftësive

1. Ministri, që ka në kompetencë forcën policore, për vlerësimin e aftësive të kandidatëve për oficer ose agent të Policisë Gjyqësore në seksion, ngre një komision të përbërë nga tre anëtarë me eksperiencë pune si oficer të policisë gjyqësore dhe/ose prokuror.
2. Komisioni merr në testim kandidatët sipas procedurës të përcaktuar në nenin 5 të këtij udhëzimi. Pas kryerjes së testimit, komisioni nxjerr menjëherë rezultatet përfundimtare.
3. Shpallja e fituesit/ve behet sipas renditjes së pikëve totale të fituara në të tre fazat e testimit.
4. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit i paraqiten brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tyre, ministrit që ka në kompetencë forcën policore.
5. Ministri përgjegjës brenda 30 ditëve nga shpallja, i dërgon Prokurorit të Përgjithshëm listën me emrat e personave të shpallur fitues për të filluar procedurën e emërimit në seksionet e Policisë Gjyqësore.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM


INA RAMA



MINISTRI I BRENDSHËM


BUJAR NISHANI



MINISTRI I FINANCAVE


RIDVAN BODE




MINISTRI I MBROJTJES


ARBEN IMAMI



**MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJRAVE**


FATMIR MEDHU

